



**Office of The General Auditor**  
**Zyra e Revizionit të Përgjithshëm**  
**Kancelarija Generalnog Revizora**



# **Raporti i Revizionit**

## **Në Buxhetin e Konsoliduar të**

### **Kosovës për vitin 2004**

# Përmbajtja

## Përmbledhja ekzekutive

### 1 Hyrje

- 1.1 Korniza e Revizionit
- 1.2 Fushëveprimi I Revizionit të BKK-së për vitin 2004
- 1.3 Standardet e Revizionit
- 1.4 Struktura e këtij Revizioni

### 2 Menaxhimi Financiar

#### 2.1 Sistemet Informative

- Hyrje
- Sistemi Ilogaritar I Thesarit
- Sistemi Ilogaritar I Tatimeve
- Sistemi I listës së pagave ( payroll)
- konkludimet

#### 2.2 Revizioni I Brendshëm

- Hyrje
- Definimet e standardeve të revizionit
- Planet e Revizionit të Brendshëm
- Rishikimi I raporteve të Revizionit
- Konkludimet

#### 2.3 Të Hyrat

2.3.1 Grandet dhe donacionet

2.3.2 Doganat

2.3.3 Tatimet

2.3.4 Tarifat dhe Gjobat

## **2.4 Shpenzimet**

- 2.4.1 Pagat dhe mëditjet
- 2.4.2 Mallrat, Shërbimet dhe Shpenzimet Kapitale
- 2.4.3 Transferet dhe subvencionet për amvisnit
- 2.4.4 Komunitat
- 2.4.5 Ndërmarrjet Publike

## **3 Pasqyrat Financiare**

- 3.1** Standardet dhe Parimet e Kontabilitetit
- 3.2** Përgatitja e Pasqyrave Financiare
- 3.3** Komentet mbi pasqyrat Financiare të vitit 2004
- 3.4** Konkludimet

## **4 komentet e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm**

### **Opinion i Revizionit**

### **Aneksi 1 Lista e veprimeve të revizionit**

### **Aneksi 2 Liste e shkurtesave**

## **Pasqyrat Financiare të buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për vitin 2004**

## Përmbledhja ekzekutive

0

Zhvillim në një masë të rëndësishme dhe inkurajuese është arritur në qeverisjen financiare në sektorin publik Kosovar në vitin aktual.

Në vitet e kaluara, firma private e kontabilitetit ka përgatitur draftet e pasqyrave financiare dhe si pjesë e këtij procesi, gjithashtu ka punuar në barazimet bankare si dhe në kompletimin dhe korrektimin në librin kryesor.

Në vitin 2004, për herë të parë, Pasqyrat Financiare të BKK-së janë përgatitur ekskluzivisht nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave (MEF) nga stafi vendor. Qartazi kjo ka reflektuar në përfitim të madh për stafin vendor.

Ngjashëm, që nga krijimi i saj, Zyra e Revizorit Gjeneral (ZRGJ) ka qenë aktive në rekrutimin dhe trajnimin e stafit vendor në auditim të jashtëm, dhe duke ju dhënë mbështetje me rekrutimin e një ekipi të vogël të specialisteve ndërkombëtar të revizionit. Prosesi është avancuar mjaft për ti mundur ZRGJ-së, megjithëse me një ndihmë të vazhdueshme të rëndësishme nga GJHR, për të marrë përgjegjësinë për revizionimin e jashtëm në pasqyrat financiare të BKK-së për herë të parë në vitin 2004.

Ne gjithë ashtu kemi vejtur përmirësim të theksuar në sistemin e TI-së që nga revizioni i kaluar, p.sh:

- Ka pas përmirësime të mëdha në kontrollet mbi Sistemin e Freebalance-it, i cili është sistem thelbësor mbi të cilën është e bazuar libri kryesor . Si rezultat i kontrolleve mbi sistemin, tash mund të ofrohet një siguri e arsyeshme lidhur me paprekshmërinë e të dhënave të prodhuara nga sistemi.
- Sistemi i ri kompjuterik " Sistemi Informativ Doganor" ( TIMS) është prezantuar me 1 Qershor 2004. Ky sistem në mënyrë të theksuar ka përmirësuar saktësinë e procesimit të të dhënave të ndërmarrura brenda Doganave. Gjithashtu siguron gjurmë të çart të revizionit që lejon të gjitha ndryshimet në të dhëna të gjurmohen. Kjo veçanërisht është e rëndësishme pasi që të hyrat doganore llogariten gati shtatëdhjetë përqind e të hyrave të

regjistruara ne Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës ( BKK).  
Megjithatë rregullimet aktuale në sistemin e sigurisë janë ta pamjaftueshme për te garantuar paprekshmërinë e sistemit.  
Sidoqoftë testimi i jonë i detajizuar i revizionit ka identifikuar shkallë të lart te saktësisë në procesimin e pagesave doganore.

1

Ne gjithashtu kemi vërejtur një progres të theksuar që është bërë mbi themelimin e kapaciteteve të Revizionit të Brendshëm brenda Sektorit Publik në Kosovë, në ngritjen e numrit të revizoreve të brendshëm si dhe numrin e raporteve të lëshuara për vitin aktual. Është e rëndësishme, megjithatë, se përfitimi maksimal është për të siguruar nga kjo ngritje në burimet, që e gjithë puna e revizionit të jetë e planifikuar në mënyrë të duhur dhe kontrollohet në përputhje me planin e revizionit bazuar në rrezikshmërinë. Për momentin është një shtrirje e theksuar në përmirësimin e kësaj fushe.

Shqetësimi jonë primar megjithatë mbetet tek natyra e fragmentuar e sistemeve financiare qe mbështjellin BKK-në. Për ta demotsruar që sistemet e saja të ndryshme janë brendësish të qëndrueshme dhe koherente, është thelbësore që elementet e ndara barazohen në mënyrë rutinore. Kjo kërkon barazime të rregullta ndërmjet:

- Sistemit Free balance në të cilin është i bazuar libri kryesor;
- Sistemet primare të mirëmbajtura nga Ministrit në mënyrë individuale, Departamentet dhe Agjensionet; dhe
- Llogarit bankare relevante;

Barazime të tilla nuk janë përgatitur në baza rutinore, dhe përpjekjet tona për ta bërë një barazim të tillë, si pjesë të revizionit tonë, ka qene mjaft e pasuksesshme.

Fakti që sistemet e ndryshme regjistrojnë shuma të ndryshme për të njëjtit artikuj, dhe atë që këto diferenca nuk mund të shpjegohen, kjo ne mënyrë të theksuar dëmton kredibilitetin e pasqyrave financiare. Në këtë kontest ne e mirëpresim themelimin e njësitit të ri në MEF, i dedikuar për barazimet e llogarive bankare, por në këtë fushë duhet të bëhet edhe më shume.

Kjo është arsyeja kryesore pse nuk kemi qenë në gjendje të shprehim mendimin tonë nëse pasqyrat financiare të bashkangjitura, të marrura si në tersi, japin një pamje të drejt dhe të vërtet për BKK të viti aktual.

# 1 Hyrje

2

## 1.1 Korniza e Revizionit

Më 10 Qershor 1999, Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara miratoi Rezolutën 1244 e cila autorizon Misionin e përkohshëm të Administrimit të Kombeve të Bashkuara (UNMIK-ut) për të vepruar si administratë kalimtare në rajon. Udhëheqësi i UNMIK-ut është Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (PSSP-ja).

Rregullorja e UNMIK-ut 1999/16, më vonë e zëvendësuar me Rregulloren 2000/7, Paragrafi 5 kërkon nga PSSP-ja që të sigurojë themelimin e Revizionit të Pavarur të përshtatshëm për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës. Ky paragraf gjithashtu kërkon që revizorët ti raportojnë Sekretarit Gjeneral të Kombeve të Bashkuara.

Me anë të kërkesës së PSSP-së, Gjykata Holandeze e Revizionit ( GJHR), ka marrë për sipër revizionin e jashtëm të BKK-së pasqyrat vjetore financiare lidhur me periudhën 1999 deri 2003.

Rregullorja e UNMIK-ut 2002/18 (datuar 4 Tetor 2002) ka themeluar bazat formale të Revizionit Gjeneral (RGj) në Kosovë. Në bazë të paragrafit 3.2 të kësaj rregulloreje Revizori Gjeneral duhet të kryejë në baza vjetore Revizionin e Rregullsisë së BKK-së. Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi të Majit 2003 (e shpallur me rregulloren 2003/17) më tutje e formalizon rolin e RGj në kryerjen e revizionit e rregullsisë të BKK-së.

Që nga krijimi, ZRGJ-ja ka qenë aktive në rekrutimin dhe trajnimin e stafit vendor në revizion të jashtëm, dhe duke ju dhënë mbështetje me rekrutimin e një ekipi të vogël të specialisteve ndërkombëtar të revizionit. Procesi është avancuar mjaft për ti mundësuar ZRGJ-së, megjithëse me një ndihmë të vazhdueshme të rëndësishme nga GJHR, për të marrë përgjegjësinë për revizion të jashtëm në të BKK-së për vitin 2004.

Këto ndryshimet në ligj dhe rregulloret e referuara më lart tani janë plotësisht efektive.

3

## **1.2 Fushëveprimi i Revizionit të vitit 2004 për BKK-në**

Objektiva parësore e këtij revizioni të BKK-së është ti mundësoj RGJ të shpreh opinionin nëse pasqyrat financiare të vitit 2004, të marrura si tersi, prezantojnë pamje të drejt dhe të saktë.

Sikurse në vitet 2002 dhe 2003, pasqyrat financiare aktuale janë pasqyra të konsoliduara në kuptimin se të hyrat dhe shpenzimet e komunave janë përfshirë përderisa ato janë regjistruar në sistemin llogaritar të Thesarit (FreeBalance). Në vitin 2002 konsolidimi nuk ka qenë i mundshëm sepse informatat e besueshme për të hyrat dhe shpenzimet e komunave në atë kohë nuk ishin në dispozicion.

## **1.3 Standardet e Revizionit**

Pasqyrat financiare të BKK-së të vitit 2004 kanë qenë subjekt i revizionit të pavarur në bazë të parimeve të parasë së gatshme dhe në pajtim me Federatën Ndërkombëtare të Kontabilistëve (IFAC), publikimet mbi Sektorin Publik të Standardeve të Kontabilitetit dhe në përgjithësi standardet e pranuar ndërkombëtare statistikore të zbatuara në sektorin publik për raportimin e buxhetit. Para se gjithash, kjo lidhet me kornizën e Statistikave Financiare Qeveritare të FMN-së.

## **1.4 Struktura e Raportit të Revizionit**

Ky kapitull hyrës është i përcjellur nga një reportazh sistematik i temave të menaxhimit financiar (kapitulli 2) dhe vërejtjeve tona në lidhje me pasqyrat financiare (kapitulli 3). Rekomandimet tona për përmirësimin e

menaxhimit financiar janë përfshirë në Listën e Veprimeve të Revizionit – 4  
shiko Aneksin 1.

Ky raport do të përfundojë me opinionet e revizionit në pasqyrat  
financiare të vitit 2004.

Pasqyrat janë të bashkangjitura dhe e formojnë pjesën integrale  
(tërësore) të këtij raporti.

## 2 Menaxhimi Financiar

5

### 2.1 Sistemet Informative

#### Hyrje

Si pjesë e revizionit të BKK-së të vitit 2004 ne i kemi kushtuar vëmendje të veçantë kontrolleve të TI-së në dhe përreth sistemit llogaritar të Thesarit (FreeBalance) dhe sistemit TIMS.

Objektivi jonë kryesorë ka qenë vlerësimi nëse ne mund të mbështetemi në kontrollet e TI-së në kryerjen e revizionit tonë.

#### Sistemi Llogaritar i Thesarit

Raporti i revizionit në pasqyrat financiare të viti të fundit tregon që menaxhimi i sistemit të FreeBalance-it ka nevojë për përmirësime. Gjatë revizionit tonë ne kemi vërejtur dobësi në lidhje me:

- Strategjinë e sistemit të TI-së dhe planifikimin i sigurisë;
- Kontrollet e qasjes, kuadrot dhe procedurat e fjalëkalimeve (password);
- Integritetin e sistemit;
- Qasjen dhe analizat e dosjeve të qasjes;
- Kontrollimin dhe mbikëqyrjen e veprimeve të drejtpërdrejta në bazën e të dhënave të FreeBalance-it.

Që nga ajo kohe është arrit progres i madh që ka qar në përmirësime domethënëse në rregullimet e TI-se Sidomos :

- Është vendosur Strategjia e TI-së
- Në mënyrë të theksuar është përmirësuar sistemi i integritetit, tek ai nivel që rregullimet e sistemit aktual janë adekuate për te

ofruar siguri të arsyeshme që integriteti, konfidencialiteti dhe disponueshmëria e sistemit aktual janë të garantuara.

6

Duhet të theksohet, megjithatë, që përderisa këto iniciativa janë të mirëseardhura dhe me vlerë, koha e prezantimit të tyre është e tillë që ofrojnë vetëm një siguri të limituar lidhur me procesimin e të dhënave që mbështjellin pasqyrat financiare të vitit 2004.

Ofrimi i nivelit të lart të varësisë së Freebalance-t në rrjetin e IT së MEF, ne rekomandojmë që këto marrëveshje të nivelit të shërbimit duhet të hartohen ndërmjet të dyjave, specifikimi i kualitetit dhe standardet e disponuara për shërbime të rrjetit të ofrohen nga TI-ja e MEF-it tek Freebalance-i.

### **Sistemi Informativ i Doganave**

Sistemi i ri Kompjuterik, TIMS, është prezantuar nga Shërbimi Doganor me 1 Qershor 2004.

Puna jonë e revizionit ka konfirmuar që sistemi i ri i TIMS-it mbështet proceset Doganore në mënyrë efektive. Përmirëson saktësinë në procesimin e deklaratave Doganore dhe parandalon keq-kalkulimet në deklarata. Problemet me diferencat në vlerësimin e mallrave janë mënjanuar, sepse të dhënat procesohen në mënyrë qëndore duke përdorur tabelat më të dhëna të përhershme. Për më tepër, sistemi TIMS ofron gjurmë revizionit që të gjitha ndryshimet e bëra në dokumentet e DUD-it mund të përcjellën.

Në përgjithësi sistemi i kontrolleve të qasjes ofron nivel themelor të sigurisë, dhënia e sistemet është e konfiguruar në mënyrë të duhur. Sidoqoftë, sistemi aktual i siguresë dhe procedurat e TI-së janë të pamjaftueshme për të garantuar paprekshmërinë, konfidencialitetin dhe disponueshmërin e sistemit.

Për të ofruar sigurinë e nevojshme, çështjet e më poshtme duhet të adresohen:

- Plani i sigurisë dhe procedurat e TI-së
- Kontrollet e qasjes, procedurat e kërkesës së qasjes dhe rregullimet e fjalëkalimit
- Siguria fizike e serverit të TIMS-it

Raporti jonë i detajizuar në sistemin TIMS ofron një numër të detajizuar të rekomandimeve të menduara të adresohen këto çështje. 7

## Konkludimet

Konkludimet tona kyçe janë:

- Ka pasur përmirësime të mëdha në kontrollin mbi sistemin e Freebalance-it. Si rezultat i kontrolleve mbi sistem, kjo tash ofron një siguri të arsyeshme lidhur me paprekshmërinë e të dhënave nga sistemi.
- Sistemi TIMS ka përmirësuar në mënyrë të theksuar saktësinë e procesimit të të dhënave të ndërmarruara brenda Doganave. Gjithë ashtu siguron gjurmë të çarta të revizionit që lejon të gjitha ndryshimet në të dhëna të gjurmohen. Sidoqoftë rregullimet aktuale të sistemit të sigurisë janë të pamjaftueshme për ta garantuar paprekshmërinë e sistemit.

## 2.2 Revizioni i Brendshëm

### Hyrje

MEF edhe në vitin 2004 ende është përgjegjëse për ofrimin e të gjitha shërbimeve të revizionit të brendshëm brenda sektorit publik në Kosovë (neni 8, Ligji mbi Menaxhimin Publik Financiar dhe të Përgjegjësisë). Në të njëjtën kohë, çdo organ brenda sektorit publik në Kosovë ka përgjegjësi të themeloj njësitin e saj të revizionit të brendshëm (plani strategjik i Nëntorit 2002), edhe pse nuk ka kushte për qeverisjen e punës së tyre. Deri në fund të vitit 2004, gjendja është siç është përmbledhur më poshtë:

Organi i sektorit publik	Numri	Njësitet e RB
Ministritë	13	10
Agjensionet	3	3
Komunat	30	30
Ndërmarrjet Publike	51	2

Në total këto njësi kanë punësuar diku 80 revizor dhe kanë lëshuar 197 raporte në vitin 2004, nga të cilat 95 i referohen viteve të mëparshme.

8

### **Definimi i Standardeve të Revizionit**

Të aplikohen standardet e revizionit dhe metodologjia brenda MEF-it është e përcaktuar në Kartën e Revizionit dhe Udhëzuesin e Revizionit e zhvilluar brenda Njësiti të Revizionit të brendshëm. Siç është përmendur më lart, nuk ka dispozita apo instruksione administrative të drejtojnë punën e njësive të revizionit të brendshëm të vendosura brenda ministrive tjera.

Instruksioni Administrativ 2003/1 jep udhëzime në qasjen që duhet të adaptohet brenda Komunave.

### **Planet e Revizionit të Brendshëm**

Nevoja fundamentale e funksionimit efektiv të revizionit të brendshëm është që aktivitetet e tij të janë të fokusuar brenda kornizës punuese e pajisur me plan të formuar në mënyrë të duhur. Për të qenë i formuar si duhet plani i revizionit të brendshëm duhet ti identifikoj të gjitha aktivitetet kyçe financiare të organeve relevante dhe ti jap prioritet punës së revizionit në përputhje me objektivat dhe vlerësimet reale për secilin rrezik që do të ballafaqohet.

Për këtë arsye në kemi kërkuar të marrim në thellësi mbulesën e cilësisë të revizionit si pjesë e revizionit tonë, duke rishikuar planet e revizionit të brendshëm të 17 organeve qendrore të sektorit publik, të vlerësojmë shtrirjen të e cila puna e tyre është krijuar në përputhje me objektivin e përcaktimit të rrezikut bazuar në planin e revizionit. Në fakt, ne kemi vërejtur që nga këto 17 organizata, 11 prej tyre nuk kanë pasur plan revizioni. Rezultatet e ekzaminimit për gjashtë të mbeturat janë përmbledhur si më poshtë:

Entiteti buxhetor	Numri i Revizioneve		
	Planifikuar	Realizuar	Ad Hok
Min e Ekonomisë & Financave	22	12	34
Ministria e Shëndetësisë	13	7	-
Min e Shërbimeve Publike	30	8	-
MKRSQJR	34	22	-
Min e Punës& Mirëqenies Sociale	60	27	
Shërbimi Doganor	12	4	-

Për më tutje, rishikimet tona në 18 njësi të revizionit të brendshëm me lokacione në komuna kemi vërejtur që shumica prej tyre nuk kanë pasur plan të aprovuar për punën e tyre.

Prandaj në përmbledhjen e rishikimeve tona vërehet se shumica e Njësiteve të Revizionit të Brendshëm nuk kanë pasur ndonjë plan të revizionit, dhe tek pjesa e vogël e rasteve ku ka ekzistuar plani, në revizionet e ndërmarra kanë realizuar vetëm pjesën e kufizuar të atyre të planifikuara. Për më tutje, të vetmin plan që ne kemi hasur që ishte i bazuar në sistemin e objektivit të vlerësimit të rrezikut ishte njësi i Revizionit të Brendshëm të MEF-it.

### **Rishikimi i Raporteve të Revizionit**

Si pjesë të revizionit tonë ne kemi rishikuar 46 raporte të lëshuara nga njësi e revizionit të brendshëm në MEF, dhe 18 raporte tjera të lëshuara nga organonët tjera në sektorin publik. Ne kemi vërejtur që në përgjithësi këto raporte detajizojnë të gjeturat e veçuara por nuk kanë arritur ndonjë vlerësim të kualitetit në kontrolleve të brendshme. Raporti nuk ka tentuar të vendos të gjeturat e tyre në një kontest të gjerë cili kontest do të bënte të mundur të riformoj procesin e revizionit ose mundësoj të gjeturat e tyre të përgjithësohen.

### **Konkludimet**

Vlera e përgjithshme e kontributit të Revizionit të Brendshëm në kontrollin e brendshëm do të shtohet në mënyrë të konsiderueshme nëse:

- Puna është kryer në përputhje me planin e revizionit e bazuar në metodën sistematike të vlerësimit të rrezikshmërisë;

- Raportet e revizionit përfshirë vlerësimet mbi kualitetin e kontrollit të brendshëm veprojnë në fushat e ekzaminuara; dhe
- Raportet e revizionit vendosin të gjeturat e tyre në kontest të gjerë që mundëson vlerësimin e rëndësisë të ndikimit në tërësi në pasqyrat financiare.

10

## **2.3 Të Hyrat**

### **2.3.1 Grandet nga Donatorët**

#### **Hyrje**

Të hyrat nga grandet përbëhen nga;

- Grandet në mbështetje të buxhetit (të pacaktuara apo grandet e përgjithshme);
- Grandet e pacaktuara të donatorëve (të lidhura në një objektivë specifike).

Përveç kësaj disa donatorë kanë ofruar mbështetje përmes të ashtuquajturës "pagesa të drejtpërdrejta". Në rast të pagesave të drejtpërdrejta donatori paguan direkt furnizuesin e mallrave dhe shërbimeve dhe asnjë nuk qarkullon përmes BKK-së. Megjithatë këto kontribute janë të përjashtuara nga pasqyra e rrjedhës së parasë së BKK-së.

#### **Të gjeturat e Revizionit**

Nuk ekziston ndonjë kontroll i brendshëm gjatë regjistrimit të grandeve në bazën e të dhënave në njësinë e grandeve të MFE-së dhe barazimi i kësaj baze të të dhënave me marrëveshjet e donatorëve. Veç kësaj nuk ka ndonjë procedurë sistematike të siguroj se të gjitha grandet janë regjistruar në mënyrë të rregullt në librin kryesor.

Më tutje, nuk ka kontroll apo procedura që të sigurojnë se kushtet e grandeve të donatorëve janë përcjellur siç janë cekur në Marrëveshjen e Mirëkuptimit. Dosjet e grandeve duhet të sigurojnë dëshmi se të gjitha kërkesat e grandit janë përmbushur. Kemi vërejtur gjatë revizionit tonë është se çdo dosje e grandeve të donatorëve tani ka listën kontrolluese të

dokumenteve të gatshme. Megjithatë këto listë-kontrolli nuk janë shfrytëzuar në mënyrë konsekuente.

11

### **Konkludimet**

Dobësitë e vërejtura në procedurat e kontrollit dhe barazimit kanë rezultuar në sigurinë e kufizuar në lidhje me plotësinë dhe korrektësinë e grandeve të donatorëve në pasqyrat financiare.

#### **2.3.2 Doganat**

##### **Hyrje**

Të Hyrat Doganore janë ndër më të rëndësishmet e burimeve të të hyrave në BKK

Në vitin 2004 këto të hyra kanë qene në shumën 436 milion euro, ose 68.5% e të gjitha të hyrave në BKK. Masa e kësaj të hyre është gjeneruar nga Obligimet e Akcizës dhe TVSH në importe, të cilat së bashku llogaritin 332 milion euro, ose 76% e totalit të të Hyrave Doganore.

Në përgjithësi, totali i të hyrave doganore në vitin 2004 barazohet me 99% e të buxhetuarave, dhe sjell pesë përqind rritje e të njëjtës shifër në 2003.

##### **Barazimi**

Veç është përmendur ( shiko paragrafin 2.1 me lart) që sistemi i ri Kompjuterik, TIMS, është prezantuar nga Shërbimi Doganor me 1 Qershor 2004, para këtij ka qenë sistemi manual ( BRICO). Përveç kësaj Doganat e UNMIK-ut mirëmbajnë një sistem bazik të Excelit në të cilat përmbliidhen të hyrat ditore.

Marrur vitin në tersi , totali I Raporteve të të Hyrave Ditore I gjeneruar brenda departamentit të doganave ishte siç është përmbledhur në tabelën e me poshtme:

Burimi I të hyrave	Vlera ( `000 Euro)
Tatimi I importit (TVSH)	286, 414
Tatimi I Importit ( akciza)	145, 657
Obligimet Doganore	70, 143
Akciza e tabakos	27, 257
Akciza e brendshme	3,448
Përziera	2,991
<b>Totali</b>	<b>435, 910</b>

Në praktik pra, janë tre shifra të ndryshëm për shumën totale të të hyrave doganore. Këto janë të përmbledhura në tabelen e me poshtme:

Burimi informativ	Vlera(` 000 Euro)
Raportet I të Hyrave ditore	435, 910
BRICO dhe TIMS ( Totali)	395, 893
Libri Kryesor	435, 973

Informata e BRICO/ TIMS është jo-komplete, sepse nuk përmban Akcizën e Tabakos dhe Akcizën e Brendshme, me shume totale përafërsisht 30 milion euro. Edhe pas llogaritjes së kësaj, megjithatë,diferenca e mbetur është ndërmjet burimeve të ndryshme të informimit por asnjë barazim nuk është bërë ndërmjet bazës së të dhënave të përfshira ose pasqyrave bankare relevante.

### **Të gjeturat e revizionit**

Si pjesë e revizionit ne kemi ndërmarr ekzaminimin e hollësishëm të mostrimit të dokumenteve burimore të prodhuara nga doganat.

Vlera e gabimeve të zbuluara si rezultat I kësaj punë barazohet me 0.2% e mostrimit të ekzaminuar, sugjeruar nivel të lart të saktësisë në procesimin Brenda Doganave të UNMIK-ut.

### **Konkludimet**

Testimi jonë I hollësishëm I transaksioneve në mënyrë individuale ofron evidenca inkurajuese të shkallës së lart të saktësisë në kalkulimin dhe mbledhjen e të hyrave doganore në mënyrë të drejt. Duke ju dhënë rëndësi të madhe të hyrave doganore në buxhetin e BKK-së si tersi, kjo është e mirëseardhur.

Sidoqoftë, në mbesim të shqetësuar për diferencat ndërmjet bazës së të dhënave kryesore të doganave, librit kryesor dhe pasqyrave bankare.

### **2.3.3 Tatimet**

#### **Hyrje**

Pasqyrat financiare të BKK-së për vitin 2004 kanë regjistruar totalin e të hyrave tatimore me shumën 114.6 Milion Euro ose 18% e të hyrave totale qeveritare. kjo është pesë përqind ngritje e të hyrave tatimore krahasuar nga tatimet e gjenrerura në vitin 2003 dhe 1.3 më shumë se të buxhetuara.

Të hyrat tatimore janë marrur nga kombinimi:

- Tatimi i paragjykuar
- Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
- Tatimi në Fitim;
- Tatimi në të ardhura personale; dhe
- Tatime tjera të vogla

#### **Barazimi**

Ka diferenca ndërmjet të hyrave tatimore siç janë të regjistruara në pasqyrat financiare të BKK-së dhe ato të shfaqura në të dhënat e Administratës Tatimore në Kosovë. Këto diferenca janë të përmbledhura në tabelën e më poshtme:

	pranimet 000 Euros		
	Pasqyrat financiare në BKK për vitin 2004	Të dhënat e Administratës Tatimore	Diferenca
Tatimi I Paragjykuar	13,140	13,754	(614)
Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	44,764	45,177	(413)
Tatimi mbi fitim	31,036	31,126	(90)
Tatimi në të ardhura	20,198	21,943	(1,745)
Të hyra tjera tatimore	5,020	-	5,020
<b>Totali</b>	<b>114,158</b>	<b>112,000</b>	<b>P/N</b>

Siç mund të shihet në tabelë, diferenca është 2.16 milion euro ( 1.95%) ndërmjet Pasqyrave Financiare të BKK-së dhe të dhënave të Administratës Tatimore.

Mospërputhja ndërmjet Pasqyrave Financiare të BKK-së dhe të dhënave të Administratës Tatimore do te ngritën, në pjesë së paku, sepse Administrata Tatimore në Kosovë regjistron të hyrat në bazë të deklaratave tatimore të pranuar nga tatimpaguesit, përdërisa Financiare e BKK-së regjistrojnë kur pagesa të bëhet nga tatim paguesit. Asnjë barazim nuk është bërë ndërmjet këtyre të dyjave, sidoqoftë, dhe nuk është e mundur, në mungesë të një barazimi të tillë, për të qenë konfident që të gjitha të hyrat tatimore janë llogaritur si duhet.

### **Inspektimet dhe revizionet e taksave**

Administrata Tatimore në Kosovë ka planifikuar në vitin 2004 te ndërmarr 4,000 inspektime tatimore. Në fakt vetëm 3,253 inspektime të tilla janë ndërmarr, përfshirë inspektimet në barazim të rreth 3.6% e tatimpaguesve.

Këto inspektime rezultojnë ne shtimin e të hyrave për 24.8 milion euro, ekuivalenti I 22.7% e totalit të të gjitha të hyrave tatimore.

Çart rezultatet e këtij niveli, të marrura nga një numër relativisht I vogël I inspektimeve, të sugjeruara që si duket të janë mjaft të rëndësishme mbi mbledhjen e të hyrave tatimore në përgjithësi.

## **Konkludimet**

15

Ka diferenca të mosbarazuara të regjistruara ndërmjet shifrave të të hyrave tatimore si janë regjistruara në librin kryesor, llogarit bankare, dhe të dhënat e mirëmbajtura nga Administrata Tatimore. Ekzistenca e diferencës së tillë dëmton kredibilitetin e pasqyrave financiare.

Autoriteti përgjegjës ka qenë shumë i suksesshëm në ngritjen e të hyrave tatimore si rezultat i inspektimeve tatimore dhe revizioneve. Dhënë këtë duket që përfitime të theksuara do të shfaqeshin nëse numri i inspektimeve do të ngrihej përtej nivelit ekzistues.

### **2.3.4 Tarifat dhe gjobat**

#### **Hyrje**

Libri kryesor i BKK-së për vitin 2004 ka regjistruar rreth 45 milion euro të të hyrave të gjeneruara nga lloje të ndryshme të të hyrave në tarifa. Rreth 35 milion euro kanë ardhur nga shtatë burime kyçe të të hyrave. Të hyrat e mbetura janë gjeneruar nga një rang i aktiviteteve me më pak rëndësi.

Veç kësaj, libri kryesor gjithashtu ka regjistruar 7.8 milion euro të hyra të ardhura nga gjobat

#### **Barazimet**

Si pjesë të revizionit tonë, ne kemi krahasuar të dhënat në librin kryesor me ato të regjistruar në sistemin operues nga organet e ndryshme përgjegjëse për ngritjen llojet e ndryshme të të ardhurave. Tabela e më poshtme ofron pamjen e rezultatit të këtij krahasimi:

Lloji i të hyrës	Vlera '000 Euro			Përqindja
	Për libër	Për burim të dokumenteve	Diferenca	Diferenca
Agjensioni i telekomit	9,876	9,400	476	4.8
Regjistrimi i Veturave	7,651	7,574	77	1.0
Tarifat e studenteve	4,720	5,160	(440)	(9.3)
Tarifat e dokumentet e udhëtimit	4,326	4,326	0	-
Tarifat e Patentë shoferëve	4,225	3,675	550	13.0
Tarifat mjekësore	2,861	2,454	407	14.2
Të hyrat tjera	10,679	---	N/a	N/a
<b>Totali i të hyrave të tarifave</b>	<b>44,338</b>	<b>---</b>	<b>---</b>	<b>---</b>
gjobat	7.830	7,284	546	7.0
<b>Totali i të hyrave</b>	<b>52.168</b>	<b>P/A</b>	<b>P/A</b>	<b>P/A</b>

Siç shihet nga kjo tabelë, në të gjitha rastet por vetëm një rast ka pasur diferenca ndërmjet shifrave të regjistruara në librin kryesor dhe ato të të regjistruara nga agjnesionet përgjegjëse. Këto diferenca janë të radhitura ndërmjet minus nëntë deri në plus 14%. Vlera totale e të gjitha diferencave të identifikuar Ishte 2.5 milion euro.

Raportet e revizionit t;e më hershme kanë theksuar që është e mundshme të krijohet një barazim I përgjithshëm I shumicës së këtyre kategorive të të hyrave nga shumëzimi I numrit të regjistrimeve, dokumenteve, licencave etj për kategori nga tarifat relevante për përcaktimin e totalit të të hyrave. Totali duhet të përbëhet me:

- Regjistrimet primare të mirëmbahen nga agjensioni I involvuar për grumbullimin e të hyrave
- Pasqyrat relevante bankare
- Libri kryesor dhe
- Pasqyrat financiare

Megjithatë sistemet duhet të përgatiten në mënyrë rutinore dhe monitorohen këto barazime në nivel të lart që nuk janë si duhet, Ne rekomandojmë që një sistem I tillë dihet të krijohet.

17

## **Të gjeturat e Revizionit**

### **Tarifat e regjistrimit të veturave**

Si pjesë e revizionit tonë kërkuam ti barazojmë regjistrimet e të hyrave të regjistrimit të veturave me pasqyrat relevante bankare. Në praktik, rezulton të jetë e pamundur të realizohet. Shqetësimet tona lidhur me këtë çështje janë theksuar nga fakti që të hyrat e regjistrimit të veturave është ulur nga 11.8 milion deri tek 7.7 milion euro që nga viti I kaluar ka ulje për 36%. Ne nuk kemi qene në gjendje të marrim sqarime lidhur më këtë dobësim.

Ne më herët kemi rekomanduar që sistemi kompjuterik duhet të prezantohet për përmirësimin e kontrollit mbi të hyrat e regjistrimit të veturave, dhe ne prapë po e përsërisim të njëjtin rekomandim.

### **Të hyrat tjera**

Ne nuk kemi qenë në gjendje të marrim ndonjë analizë apo dokument për të 10.7 milion euro të përfshira në pasqyrat financiare si " të hyra tjera" ose ekuivalentin e 1.8 % e totalit të BKK-së.

Prandaj në nuk kemi në gjendje të krijojmë një pamje nëse ka shifra e përfshirë në pasqyrat financiare është korrekte apo jo.

## **Konkludimet**

Ka diferenca të pabarazuara ndërmjet shifrave të të hyrave për kategori të ndryshme të të hyrave në tarifa si të regjistruara në librin kryesor, llogarit bankare dhe të dhënat e mbajtura nga Administrata Tatimore. Ekzistenca e një difference të tillë dëmton kredibilitetin e pasqyrave financiare.

Ne vërejtëm që tarifat mbi regjistrimin e veturave janë ulur për 36% në vitin aktual por nuk kemi mund të marrim sqarime lidhur më këtë ulje.

Ne nuk kemi mund të marrim ndonjë dokument mbështetës lidhur me " të hyrat tjera" dhe kështu nuk kemi mundur të kryejmë revizion lidhur me 10.7 milion euro. 18

## 2.4 Shpenzimet

### 2.4.1 Pagat dhe mëditjet

#### *Hyrje*

Masa e madhe e shpenzimeve të listës së pagave që raportohet në pasqyrat financiare të BKK-së është e procesuar nëpërmjet dy sistemeve kyçe. Libri kryesor për të dhënat e 2004 shumat në fjale janë si në vijim:

- Ministria e Shërbimeve Publike ( MSHP)- 157.3 milion euro
- Shërbimi Policor I Kosovës (SHPK) – 21.8 milion euro

Veç kësaj, MEF-I mban numër të kufizuar të listës së pagesave në mënyrë të drejtpërdrejt.

Në vitin 2004 shuma totale e pagesave të tillë ka qenë 5.7 milion euro.

Një analizë e këtyre shifrave është prezantuar në tabelën e më poshtme:

Expenditure Classification	Euros '000			
	Pasqyrat Financiare	Lista e Pagave MShP	Lista e Pagave SHPK	Pagesat Direkte
<b>Pagat neto</b>	160,964	137,702	19,100	4,162
<b>Tatimi në pagë</b>	5,924	4,454	765	705
<b>Kontributi pensional – punëshënësi</b>	8,677	7,488	991	198
<b>Kontributi pensional - punëtori</b>	8,675	7,488	991	196
<b>Pagesat e kontraktuara</b>	501	0	0	501
<b>Skema e pagesave të ushqimit</b>	31	0	0	31
<b>Pagesat stimuluese</b>	41	0	0	41
<b>Pagesat e ndërrimeve</b>	2	0	0	2
<b>Totali</b>	184,815	157,132	21,847	5,836

### **Të gjeturat e revizionit – listës së pagave të Ministrisë së Shërbimeve Publike**

Si pjesë e revizionit tonë në kemi rishikuar hollësisht mostrimin e 84 dosjeve të personelit të selektuara si më poshtë

- 17 nga MEF-I
- 9 nga MTI
- 58 nga MSh

nga gjithë këto 55 prej tyre ishin jo complete ose të mangëta në një nga njëra anë apo tjetra dhe nuk plotëson kërkesat e Rregullores 2001/36. Mangësia e përbashkët që kemi vjetur është se paga ka vazhduar ti jepet një punëtori të MSh tre muaj pas përfundimit të mardhënjeve të punës.

Ne gjithashtu kemi ekzaminuar me anë të mostrimin shumë e 5.7 milion eurove të pagesave të listës së pagave të bërë drejtpërdrejt nga ana e MEF-it. Ne vërejtëm:

- Nëntë prej pagesave të selektuara për ekzaminim, dy prej tyre nuk kanë pasur të gatshëm ndonjë dokument mbështetës
- një pagesë, me shumë 0.9 milion euro e bërë për Minierat e Trepçës nuk është dashur të klasifikohet si shpenzim I listës së pagave.

Më tutje, ne kemi vërejtur disa raste ku disa punëtor janë të futur në disa lista të pagave. Kjo është në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ Nr 03, I cili thotë që I punësuari ka të drejt të pranoj vetëm një rrogë nga BKK-ja. Shuma nuk është materiale.

Gjithashtu kemi vërejtur që nuk është bërë asnjë barazim ndërmjet sistemit të MShP-së dhe pasqyrave relevante bankare.

## **Të gjeturat e Revizionit – e listë së pagave të Shërbimit Policor I Kosovës** 20

Nuk ka proces rutinor për barazimin e shpenzimeve të listës së pagave të ShPK-së si të regjistruara në librin kryesor me ato të regjistruara në sistemin e ShPK-së, apo me ndonjë pasqyre bankare relevante.

Si pjesë të revizionit ne kemi realizuar barazim të duhur . Si rezultat I kësaj procesi ne kemi identifikuar të poshtë shënuarat;

- Libri kryesor për Qershor të viti 2004 ka përfshirë një kthim të transaksionit me shumë 525.000 euro. Në fakt këto transaksione do të duhej të janë për 2.75 euro, por muaji në tersi I shpenzimeve të pagave është kthyer gabimisht;
- Shpenzimet e pagave në shumën 10, 952 euro lidhur me 2005 janë regjistruar në 2004 gabimisht
- Dy transaksione të pagave me vlerë 192,649 euro dhe 537, 988 euro të përfshira ne librin kryesor, nuk janë futur ne llogarit bankare

Korrektimet e kërkuara janë bërë pasi që pasqyrat financiare të BKK-se janë prezantuar për revizion.

### **Konkludimet**

Ne kemi vërejtur që shifrat e regjistruara ne listën e pagave të MShP-së janë në përputhje me ato të regjistruara ne librin kryesor. Por megjithatë asnjë nga burimet nuk është barazuar me llogarit bankare. Ne rishikimet tona të hollësishme të 84 dosjeve të personelit në MShP kemi vërejtur që shumica e këtyre dosjeve nuk plotësojnë plotësisht kërkesat e udhëzimeve administrative relevante.

Revizioni jonë në listën e pagave të bëra drejtpërdrejt nga MEF-I ka identifikuar numër I ti cili ose nuk kanë qenë korrekte ose nuk mund te verifikojmë më reference të dokumentit burimor.

Si pjesë të revizionit tonë ne kemi përgatitur barazimin ndërmjet shpenzimeve të listës së paganë të ShPK-së të regjistruara në librin kryesor, të dhënat e ShPK-së dhe pasqyrat bankare relevante. Ajo na ka drejtuar te identifikimi dhe korrektimi I një numri të theksuar të gabimeve.

#### 2.4.2 Mallrat, Shërbimet dhe Shpenzimet e Kapitalit

##### *Hyrje*

Shpenzimet në mallra, shërbime dhe shpenzime kapitale në vitin 2004 arrijnë në € 377, 882, 485 Euro.

Deri në gjysmën e vitit, këto shpenzime është kërkuar të kryhen në përputhje me Udhëzimet Administrative Financiare (UAF) 1/1999, 2/1999 dhe 6/2000. Që nga 9 Qershori hyri në fuqi legjislacioni I ri lidhur me prokurimin publik në Kosovë. Megjithatë, krijimi I vonuar I dokumenteve standarde dhe vonesa në trajnimin e stafit relevant ka penguar rregulloren e re të aplikohet në praktik në vitin 2004.

Ne kemi bërë revizionin e shpenzimeve bazuar në rishikimin e hollësishëm me mostrimin e 157 pagesave me shume totale 21.7 milion euro të selekuara nga libri kryesor. Këto pagesa janë rishikuar për tu siguruar që pagesat janë bërë në mënyrë korrekte, të mbështetura më dokumentacione të duhura, dhe se proceset e prokurimit a janë kryer në përputhje me rregulloret që kanë qenë në fuqi në atë kohë.

##### **Të gjeturat e revizionit**

Mostrimi i 157 pagesave të ekzaminuara përmban llojet e transaksioneve të poshtë shënuara:

<b>Lloji I pagesës</b>	<b>Numri</b>	<b>Vlera (Euro 000)</b>
Pagesat e Drejtpërdrejta nga Donatorët	2	224.5
Transaksionet e Kthyera	11	(4,743.6)
Pagesat Normale	144	26,251.8
<b>Totali</b>	<b>157</b>	<b>21,732.7</b>

Pagesat e Drejtpërdrejta nga donatorët nuk duhet të përfshihen të pasqyrat financiare të BKK-së, MEF-I pastaj pas përjashtimit të dy pagesave të drejtpërdrejta të identifikuar gjatë revizionit tonë nga Pasqyrat Financiare të vitit 2004.

Pavarësisht nga kërkesat e përsëritura, ne nuk ishim në gjendje të marrim ndonjë dokumentacion mbështetës për 11 transaksionet e kthyer, të identifikuar nga mostrimi jonë. Qartazi kjo çështje është shqetësim serioz.

Pagesat normale 144 prej tyre të mostruara, kanë qenë të masave të ndryshme dhe siç është kërkuar të kryhen në përputhje sipas nivelit të metodave të prokurimit, siç janë ekspozuar në tabelën e më poshtme:

<b>Vlera e transaksionit (Euro)</b>	<b>Metoda e kërkuar e prokurimit</b>	<b>Numri në mostrim</b>
Nën 1,250	Blerjet një burimore	11
1,250 – 25,000	Blerjet konkurruese	50
mbi 25,000	Blerjet tenderuese	83
<b>Totali</b>		<b>144</b>

Siç u vërejt më lart, me 9 Qershor 2004 ka hyrë në fuqi legjislacioni i ri lidhur me qeverisjen e prokurimit në sektorin publik, por kjo nuk është praktikuar në praktik. Prandaj revizioni jonë është fokusuar në vlerësimin se transaksionet e ekzaminuara deri ku janë përputhur me kërkesat e rregulloreve të më hershme, të cilat kanë ndikuar që nga Qershori 2004 me ndryshimet I legjislacionit të ri. Rezultati I ekzaminimit tonë është përmbledhur në tabelën e më poshtme:

<b>Metodat e prokurimit</b>	<b>Përputhje</b>	
	<b>Po</b>	<b>Jo</b>
<b><i>Blerje njëburimore</i></b>		
Përputhje me procedurat e pagesës	10	1
Përputhje me rendin e përshkruar të autorizimit	8	3
<b><i>Blerje Konkurruese</i></b>		
Përputhje me procedurat e pagesës	43	7
Përputhje me rendin e përshkruar të autorizimit	33	17
<b><i>Blerje tenderuese</i></b>		
Përputhje me procedurat e pagesës	82	1
Përputhje me rendin e përshkruar të autorizimit	68	15
<b>Totali</b>		
Përputhje me procedurat e pagesës	135	9
Përputhje me rendin e përshkruar të autorizimit	109	35

Në përmbledhje, për afërsisht 32% e rasteve të ekzaminuara procesi autorizimit siç është i përshkruar nuk është aplikuar. I njëjti problem është i bërë edhe në pranimin e mallrave para se urdhëresat të janë nënshkruar dhe zotimet janë bërë para përvetësimeve përkatëse dhe mungesa e dokumentacionit. Ne gjithashtu kemi gjetur një numër të vogël të gabimeve në kalkulim.

Edhe pse kjo është një dukuri e papranueshme lart e parregullsive, është një ulje e theksuar krahasuar me shifrat e viti të kaluar ( 61 % ) .

Ndryshe nga viti I kaluar, nuk kemi gjetur asnjë rast ku kontrata e shkruar nuk ka qenë rregull për blerjet me vlerë mbi 25,000 Euro, ose kanë qenë procedurat e prokurimit të specifikuara në IAF 2/99 nuk janë përcjellur.

### **Konkludimet**

Konkludimet kyçe që dalin gjatë rishikimeve tonë në prokurim janë:

- Ligji I ri I Prokurimit që ka hyrë në fuqi me 9 Qershor 2004, në praktik nuk është aplikuar gjatë vitit 2004.
- Ekzaminimi jonë në pagesat normale të revizuara si pjesë e mostrimit tonë ka identifikuar dukuri të lart të mos përputhjes me rregulloret e prokurimit që do të thotë 34 përqind, edhe pse gjendja është përmirësuar në mënyrë të theksuar që nga viti I kaluar, ku shifrat krahasuese kanë qenë 61 përqind.

### **2.4.3 Transferet dhe subvencionet për ekonomitë shtëpiake**

#### **Hyrje**

Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale (MPMS) është përgjegjëse për pagesat e pensioneve dhe format tjera të asistencës sociale tek amvisnit me nevoja financiare. Sipas të dhënave të MPMS, totali i asistencës sociale të shpërndara nga kjo ministri në vitin 2004 ka qenë 101.2 milion euro. Mbi gjysma e këtyre shpenzimeve ( 54.3 përqind) është paguar për pensione bazë, mandej një e treta ( 32.1 përqind) është paguar tek amvisnit që vuajnë nga papunësia. Shuma tjetër e mbetur 18 përqind është paguar për të pa aftit për punë dhe pensionet e luftës.

### Barazimet

Siç është vërejtur më lart, sipas të dhënave që posedon MPMS, totali i shpenzimeve për vitin 2004 në formë të ndryshme të asistencës e administruar nga ata ka qenë 101.2 milion euro. Libri kryesor përmban përfaqësisht totalin me 3.1 milion më pak se kjo, ndërsa të dhënat e pasqyrave financiare një shifër pak më të lart. Analizat e këtyre totaleve përmes kategorive të ndryshme përfituese është e përmbledhur në tabelle e më poshtme:

Kategoritë përfituese	Vlera (Euro `000)		
	MPMS	Libri	Banka
<b>Pensionet Bazë</b>	54,916	51,863	54,937
<b>Asistenca Sociale</b>	32,515	32,611	32,495
<b>Pensionet për të paafit/ e luftës</b>	11,835	13,776	8,918
<b>Trepça</b>	1,883	1,821	
<b>Pagesat tjera</b>	42	36	--
<b>Totali</b>	101,191	100,107	96,350

Siç mund të shihet, edhe pse ka mospërputhje në të gjitha kategoritë përfituese, diferenca ndërmjet pagesave të regjistruara për Pensione Bazë dhe për të pa aftit për punë në MPMS dhe librin kryesor janë kryesisht të larta. Shumica e këtyre diferencave ngritët si rezultat i regjistrimeve të gabuara, ndonëse në rastin e Pensioneve për të paafit/ pensionet e luftës, ne kemi vërejtur që 2.9 milion euro të pagesave për persona të paafitë e regjistruar në sistemin e MPMS nuk është regjistruar në librin kryesor deri në përfundim të vitit 31 Dhjetor.

Arsye tjetër për mospërputhje është që edhe pse pagesat e anuluar janë korigjuar në librin kryesor, në sistemin e MPMS nuk i kemi vërejtur. Ka diferenca të mëdha në parim dhe praktik ndërmjet mënyrës se si i njëjti shpenzim është i regjistruar në sistemin e MPMS dhe në librin kryesor, edhe pse në mungesë të barazimeve formale ndërmjet këtyre nuk është e mundur të sigurojmë se si këto diferenca mund të

shpjegojnë diferencat ne para të gatshme të theksuara në tabelën më  
lart.

25

### **Të gjeturat e revizionit**

Si pjesë e revizionit tonë, ne kemi rishikuar rregullimet e vendosura në MPMS për kontrollimin e 32.5 milion euro shpenzime në pagesat e Asistencës Sociale.

Gjatë vitit 2004, ndërmjet 44,000 dhe 51, 000 amvisni kanë pranuar pagesa nga Asistenca Sociale. Njësiti i Menaxhimit Operativ ( MPO) në MPMS ka ndërmarr rishikimin e dosjeve të dokumenteve që mbështesin për afërsisht 10,839 të këtyre rasteve, ose për afërsisht një çerek të totalit dhe mandej verifikim të drejtpërdrejt të 1, 452 raste. Këto kanë qenë të ndara gati njëjtë ndërmjet rasteve të Kategorisë së 1 ( amvisnit që nuk kanë asnjë person të aftë për punë) dhe Kategoria 11 ( amvisnit që kanë së paku një person të aftë për pune, por i papunësuar)

Ne kemi përmbledhur rezultatin e punës së tyre në tabelën e më poshtme:

<b>Përmbledhja e të gjeturave nga raportet e inspektimit – 2004</b>						
<b>Komuna</b>	<b>Dokumentacionet e kontrolluara</b>			<b>Verifikimi i drejtpërdrejt</b>		
	<b>Kategoria I</b>	<b>Kategoria II</b>	<b>Pakompletuar</b>	<b>Kategoria I</b>	<b>Kategoria II</b>	<b>Jo I pranueshëm</b>
Klina	147	125	3	26	42	4
Lipjani	223	153	0	56	37	1
Istogu	102	121	0	27	30	1
Ferizaj	203	183	0	50	46	2
Prizreni	420	335	0	91	101	16
Skenderaj	349	282	0	58	95	28
Prishtina	451	463	67	121	143	45
Dragashi	132	82	0	28	28	1
Mitrovica	338	438	5	57	93	12
Deçani	59	71	0	18	23	1
Malisheva	49	56	5	10	24	2
Gjakova	88	77	2	29	21	2
Gjilani	85	76	3	23	26	6
F.Kosovë	62	60	4	15	20	6
Peja	129	121	0	20	24	1
Shtime	43	77	6	11	21	0
Rahovec	51	74	1	13	17	2
Vushtrri	134	166	0	18	42	6
Suharekë	98	102	0	19	21	1
Podujevë	108	134	5	22	38	1
Obiliqi	29	25	0	3	7	0
Kaçanik	64	116	0	19	26	0
Glogovc	131	170	0	21	39	3
Viti	107	93	0	19	21	3
Shtërpce	20	20	0	5	5	0
Firajë	22	28	7	4	6	0
Kamenicë	50	50	0	10	10	1
Ranillug	44	36	0	3	13	0
Klina	94	106	38	19	21	6
Lipjani	107	133	8	18	37	1
Istog	98	103	0	16	24	0
Ferizaj	101	130	0	25	35	0
Prizreni	173	132	0	38	19	0
Skenderaj	191	127	0	29	31	13
Dragashi	106	99	2	12	18	2
Prishtina	234	177	0	31	28	8
Mitrovica	197	260	0	47	53	0
Deçani	145	170	0	23	36	0
F.Kosova	139	145	0	19	21	0
Malisheva	100	100	0	15	22	0
<b>Totali:</b>	<b>5,423</b>	<b>5,416</b>	<b>156</b>	<b>1,088</b>	<b>1,364</b>	<b>175</b>
<b>Përqindja</b>			<b>1.4</b>			<b>7.1</b>
<b>Vlera - Euros</b>			<b>455,206</b>			<b>2,276,031</b>

Siç mund të shihet nga tabela, dosjet e rishikuara kanë identifikuar 1.4 përqind të rasteve ku dokumentacionet që mbështesin çështjet e pagesave kanë qenë në një mënyrë të mangëta. Duke aplikuar këtë përqindje të shumen totale të pagesave të Asistencës Sociale sugjerohet që 455,000 euro të pagesave të bëra në vitin 2004 nuk janë mbështetur

në mënyrë adekuate me dokumentacione dhe për këtë arsye mund të  
janë me vlefshmëri të dyshimtë.

27

Më shumë shqetësuese, 7.1 përqind e këtyre rasteve të verifikuara në  
mënyrë direkte janë zbuluar se janë të papranueshme. Duke aplikuar  
përqindjen e shumës totale të pagesave të Asistencës Sociale sugjerohet  
qe përafërsisht 2.3 milion euro të pagesave në vitin 2004 janë të  
papranueshme.

### **Konkludimet**

Ka diferenca të mëdha në parim dhe praktik ndërmjet mënyrës se si i  
njëjti shpenzim është i regjistruar ne sistem e MPMS dhe në librin  
kryesor, dhe informacionet ndërmjet këtyre dy burimeve nuk janë  
barazuar.

Ky informacion nuk është barazuar as me të dhënat bankare.

Kërkohet një qëndrueshmëri më e madhe e sidomos në;

- Aplikimin e ndërprerjes së fund vitit në një pikë të caktuar
- Regjistrimin e pagesave të anuluar.

Rishikimi i Dosjeve të NMP-së dhe verifikimet e drejtpërdrejta sugjerojnë  
standard të dokumenteve gatshme që mbështesin pagesat e Asistencës  
Sociale janë përmirësuar që nga viti i kaluar, por puna e tyre ende duke  
hasur në mënyrë shqetësuese një sasi të lart të pagesave të pa  
pranueshme.

#### **2.4.4 Komunat**

##### **Hyrje**

Rregullorja 2000/45 mbi vetëqeverisjen e komunave siguron udhëzime në  
tema të ndryshme të menaxhimit financiar të komunave, përfshirë  
raportet vjetore (neni 42) dhe revizionin e pavarur (neni 43). Rregullorja  
kërkon nga komunat që të publikojnë raportin vjetor (të revizionimit) jo  
më vonë se me 30 Maj të vitit të ardhshëm fiskal. Autoriteti Qendror

duhet të caktoj një revizor të pavarur për të revizionuar pasqyrat  
financiare të secilës komunë (neni 43.1).

28

Në praktik, komunat janë kanal kryesor për shpenzime publike në  
Kosovë, dhe gjithashtu janë përgjegjëse për menaxhimin e shumicës së  
burimit të të hyrave. Këto transaksione në fakt janë konsoliduar në  
llogarit e BKK-së dhe janë raportuar në pasqyrat financiare vjetore që  
janë të bashkangjitura.

### **Rregullimet e revizionit të jashtëm**

AQF-ja/MEF-i kanë vendosur që revizionimi i jashtëm për komuna të  
ndermerret nga një firmë private e revizionit , ka përcaktuar konkurrimin  
tenderues.

Në fakt, historikisht, revizionimi i jashtëm i pasqyrave financiare të  
komunave të Kosovës ka rezultuar në vetëm disa opinione të pa  
rezervuara të revizionit. Prej 30 Komunave, edhe pse 19 prej tyre kanë  
pranuar opinione të pa rezervuara 2001, në vitin 2002 shifra krahasuese  
ka qenë vetëm tri. Në vitin 2001 dy komuna të revizionuara kanë  
rezultuar me opinion të rezervuar, të gjitha të tjerat kanë rezultuar në  
refuzim të opinionit. kjo do të thotë revizori ka refuzuar të jap ndonjë  
opinion lidhur me pasqyrat sepse ka pas nivel të lart të gabimeve dhe  
paqartësive të identifikuar gjatë revizionit. Në vitin 2002 nuk ka pasur  
opinion të rezervuar , kjo do të thotë përveç tri komunave që kanë  
rezultuar më opinion të pa rezervuar , për të gjitha revizionet tjera është  
refuzuar opinion.

Nuk ka pasur revizion të jashtëm në komunat e Kosovës që nga viti 2002.  
MEF-i, në bashkëpunim me RGj të Kosovës, ka lëshuar një tender për  
revizionin e vitit 2003 dhe 2004, por kombinimi i problemeve  
administrative dhe ndryshimet rregullative kanë vonuar konkludimin e  
këtij procesi. Edhe pse kjo është kuptuar se është çështje tenderi tani  
është afër finalizimit, fakti ekzistues është në kohën për shtypjen e  
pasqyrat financiare të revizionuara për komunat e Kosovës për vitin 2004  
nuk janë të gatshme.

### **Të gjeturat e revizionit**

Për ta mbuluar zbrazëtirën në revizion të jashtëm , ZRGj-ja ka ndërmarr revizionin në këtë fushë, duke u fokusuar në vitin 2004. Puna ka përfshirë rishikimin e rregullimeve në komunat e selektuata, ,për të shikuar nëse rregullimet ekzistuese të revizionit të brendshëm janë të knaqshme. Rezultat e kësaj pune janë raportuar në piken 2.2 të këtij raporti por në përmbledhja e konkluzionit të përgjithshëm është se një progres i theksuar është bërë ne themelimin e departamenteve revizionit të brendshëm në komuna, këto departamente nuk janë ende plotësisht efektive.

Ne gjithashtu kemi ndërmarr program mbi rishikimin e rregullimeve të prokurimit dhe menaxhimin e pasurisë në komuna.

Rezultatet e punës tonë në rregullimet e prokurimit është i përmbledhur në tabelën e më poshtme:

<b>Komuna</b>	<b>Prokurimet harxhuar (Euro000)</b>	<b>Mostra e ekzaminuar (Euro000)</b>	<b>Norma e gabimeve (Euro000)</b>	<b>Norma e gabimeve (përqindje)</b>
<b>Deçan</b>	1,402.5	904.0	193.8	21.4
<b>Drenas</b>	1,439.5	814.7	785.8	96.5
<b>Ferizaj</b>	4,373.2	515.4	334.2	64.8
<b>Fushë Koso</b>	2,717.9	1,294.8	1,268.6	98.0
<b>Gjakova</b>	3,168.5	1,634.4	260.1	15.9
<b>Gjilan</b>	4,765.3	3,199.0	682.6	21.3
<b>Istog</b>	2,358.6	753.4	283.9	37.7
<b>Kamenicë</b>	1,334.1	742.1	238.5	32.1
<b>Kaçanik</b>	1,564.6	1,217.7	438.5	36.0
<b>Klinë</b>	2,183.4	1,016.4	235.6	23.2
<b>Malishevë</b>	1,324.7	1,324.7	1,176.4	88.8
<b>Mitrovicë</b>	2,059.1	433.9	163.6	37.7
<b>Novobërdë</b>	672.8	58.7	37.2	63.4
<b>Obiliq</b>	563.9	390.0	33.8	8.7
<b>Prishtinë</b>	15,003.4	4,651.7	4,448.6	95.6
<b>Rahovec</b>	2,319.1	1,644.0	1,613.9	98.2
<b>Shtime</b>	1,204.9	984.2	304.2	30.9
<b>Suhareka</b>	2,814.1	2,195.5	577.0	26.3
<b>Vushtrri</b>	2,848.9	1,185.1	452.6	38.2
<b>Totali</b>	<b>54,118.5</b>	<b>24,959.7</b>	<b>13,528.9</b>	<b>54.2</b>

Siç mund të shihet në tabelën, 19 komunat e ekzaminuara raportojnë shumën totale 54.1 milion euro në prokurimin e vitit 2004. Ne kemi

ekzaminuar 25.0 milion euro, ose 46.2 përqind të shpenzimeve, dhe parregulluesit e zbuluara të njërit apo llojit tjetër në dokumentacione përmbajnë 13.5 milion euro, kjo është 54.2 përqind e shpenzimeve të ekzaminuara.

30

Llojet me të përbashkëta të çështjeve të identifikuar nëpërmjet revizionit tonë kanë qenë:

- Procedurat e kërkuara të prokurimit janë hequr pa marrjen e aprovimit të duhur;
- Tenderi më i ulët nuk është pranuar, në disa raste pa shpjegim të çart lidhur me vendimin e marrë;
- Shpenzimet kanë ndodh para zotimit të duhur;
- Puna e kompletuar para lëshimit të kontratës relevante;
- Puna nuk është kryer sipas specifikacionëve;
- Ndëshkimet nuk janë aplikuar kur është kërkuar;
- Pagesat e bëra nuk përputhen me shumat e kontratave;
- Dosjet e pa kompletuara, mungon dokumentacion kyç;

#### Konkludimet

Deri tani revizionet e pasqyrave financiare për komuna për vitin 2004 nuk janë ndërmarr dhe ne kemi vërejtur që historikisht, revizionet e jashtme të komunave kanë rezultuar në nivel të lart të refuzimit të opinionit.

Puna e ndërmarr nga ZRGJ-ja ka vërejtur që rregullimet e revizionit të brendshëm në komuna në vitin 2004 nuk kanë funksionuar në mënyrë efektive, përderisa punët tjera të ndërmarr nga ZRGJ-ja vërehet që rregullimet e prokurimit dhe menaxhimi i pasurisë në komuna për vitin 2004 kanë qenë të dobëta

Prandaj në përgjithësi, ka arsye të rëndësishme për shqetësimin rreth kualitetit të menaxhimit financiar dhe llogaritjes në komuna.

#### **2.4.5 Ndërmarrjet publike**

##### **Hyrje**

Sektori i ndërmarrjeve publike në Kosovë përbëhet prej organizatave në vijim:

**I Shërbimet Publike**

- Kompania Energjetike e Kosovës (KEK)
- Ndërmarrjet e ngrohjes qendrore
- Kompanitë e ujit dhe mbeturinave

**II Transporti dhe komunikimi**

- Hekurudhat e Kosovës (HK)
- Aeroportin e Prishtinës dhe Shërbimet e trafikut ajror
- Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës (PTK)

**III Industriale**

- Kompleksi i minierave të Trepçës

Në Qershor të vitit 2002 është krijuar Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) si një organ i pavarur përgjegjës për ndërmarrjet publike.

Ndërmarrjet publike	Viti financiar				
	2000	2001	2002	2003	2004
<b>Shërbimet komunale</b>					
<b>Rryma</b>	--	Refuzuar	Refuzuar	kualifikuar	--
<b>Nxemja qendrore *</b>	--	--	--	Refuzuar	Refuzuar
<b>Mbaturinat / Uji</b>	Letra menaxhmentit			--	--
<b>Transportimi etc</b>					
<b>Hekurudhat e Kosovës</b>	--	Refuzuar	Refuzuar	--	--
<b>Aerporti &amp; ATS</b>	Refuzuar	Refuzuar	Refuzuar	Refuzuar	Refuzuar
<b>Posta &amp; Telekomunikacioni</b>	--	Refuzuar	Refuzuar	Refuzuar	Refuzuar

\*Opinionet e revizionit në dispozicion janë lidhur me vetëm dy Skema të Nxemjes së Qytetit.

Siç mund të shihen të gjitha përveç njëra nga revizionet ekzistuese ka konkluduar refuzim të opinionit, është deklaruar që në fakt revizori nuk ka qenë në gjendje të krijoj një pamje mbi saktësinë ose ndryshe

pasqyrat financiare duhet të janë në dispozicion për revizion. Në vijim do 32  
ti ilustrujmë llojet e problemeve që janë identifikuar nga revizoret:

- paqartësia e pronësisë dhe vlerësimi i pasurive (nuk është e mundur të konstatohen nëse disa pasuri të cilat datojnë para periudhës së vitit 1999 janë paraqitur saktësisht në pasqyrat financiare);
- mungesa e librit kryesor adekuat , regjistrat e pasurive fikse dhe librat për inventarë.
- mungesa e dëshmive dokumentuese dhe informacioneve
- dobësi të dukshme në sistemin e kontrollit të brendshëm;
- rreziqet të konsiderueshme nga mos regjistrimi i të hyrave dhe shpenzimeve
- paqartësi mbi vlerësimin e obligimeve të fondit pensional;
- Kontabiliteti nuk është zhvilluar në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të kontabilitetit.

### **Konkluzionet**

Në përmbledhje, raportet e revizionit të jashtëm të vitit 2004 ( dhe në fakt ato të viteve të kaluara) të ndërmarrjeve publike nuk japin siguri për (rregullsinë e) subvencioneve dhe transferove në këto ndërmarrje publike të regjistruara në pasqyrat financiare të vitit 2004.

## **3 Pasqyrat Financiare**

33

### **3.1 Standardet dhe parimet e kontabilitetit**

Pasqyrat financiare të BKK-se për vitin 2004 janë përgatitur sipas kornizës të përgjithshme punuese e lëshuar nga Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit( LMFP) në Maj 2003.

Pasqyrat e bashkangjitura të BKK-së për vitin 2004 janë përmbajtur sipas kësaj kornize punuese dhe parimet e kontabilitetit (parave të gatshme) e promulguar nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve(FNK) lidhur me Raportimin Financiar nga Ndërmarrjet Qeveritare përfshirë Standardet e Kontabilitetit Sektorin Publik dhe standardet ndërkombëtare gjenerale të pranuar statistike të aplikueshme mbi raportimin e buxhetit në sektorin publik ( para së gjithash korniza punuese e Fondit Monetar Ndërkombëtare mbi Statistikat Financiare Qeveritare)

Ligji mbi menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Neni 42) kërkon që RGJ të raportoj në Parlament dhe tek PSSP-ja për pasqyrat financiare ( në mënyrë të drejt dhe të vërtet) të organizatave buxhetore, më së voni me 30 Qershor duke përcjellur vitin financiar paraprak.

### **3.2 Përgatitja e pasqrave financiare**

Vitin e kaluar, një firmë private kontabiliteti ka përgatitur draftet e pasqrave financiare dhe në kuadër të këtij angazhimi kjo firmë ka punuar edhe në barazimet bankare dhe në kompletimin dhe korrektimin e librit kryesor. Në vitin 2004 , për herë të parë, pasqyrat financiare janë përgatitur në mënyrë ekskluzive nga Ministria e ekonomisë dhe Financave ( MEF) nga stafi vendor.

Qartazi ky është një hap i madh përpara dhe reflekton lëvdatë të madhe për gjithë stafin e MEF-it. Për pjesën tonë, gjatë këtij procesi ne kemi bashkëpunuar ngushtë me MEF-in, dhe kemi dhënë një numër sugjerimesh që kanë rezultuar në ndryshimin e draftit të parë të pasqrave financiare të prezantuara për revizion në Prill të vitit 2005.

Versioni final i pasqyrave financiare të BKK-së për vitin 2004 nënshkruar dhe prezantuar për revizion me 9 Nëntor 2005. **34**

### **3.3 Komentet mbi pasqyrat financiare të vitit 2004**

#### **Bilancet bankare**

Revizioni jonë në bilancet bankare të raportuar në pasqyrat financiare vazhdon të ngjallë brenga fundamentale, sidomos pasi që:

- MEF-i nuk ndërmerr barazime të rregullta të llogarive të ndryshme bankare në përdorim nga BKK-ja. Barazimet e tilla janë mekanizëm më së i domosdoshëm në sigurimin e monitorimit efektiv dhe kontrollimin e financave qeveritare.
- Me sa duket, së paku pjesërisht si rezultat i asaj më lart, pasqyrat e rrjedhjes së parasë përfshinë diferencat e pabarazuara të 348,703 euro ndërmjet bilancit të parasë të raportuar në pasqyrat financiare dhe ato të regjistruara në pasqyrat bankare. Edhe pse kjo shifër është e vogël në kontekst të pasqyrave financiare si tersi, por megjithatë është e rëndësishme sepse mund të përfaqësoj diferencën neto ndërmjet serive në kompensimin e diferencave më të mëdha.
- Vazhdon të ketë pasiguri rreth identitetit të të gjitha llogarive bankare që veprojnë në emër të BKK-së, llogari të cilat duhet të përfshihen si pjesë e Pasqyrave Financiare të BKK-së.
- Pamundësia e dokumentacionit komplet të pasqyrave bankare na ka penguar të bëjmë verifikim të pavarur në interesin dhe detyrimet bankare të raportuara gjatë vitit.

#### **Bilancet e parave në dorë**

Siç është raportuar në vitin e kaluar, nuk kemi siguri për bilancet e parave në dorë në pasqyrat financiare sepse nuk ka pasur të dhëna për pagesat e kruara me para në dorë.

Qartazi kjo është një çështje shqetësuese, edhe pse ngritja e nivelit të përdorimit të transferove bankare do të thotë rëndësia e saj po e ulë rëndësinë.

### **3.4 Konkludimet**

Progres i theksuar është bërë brenda vitit në MEF. Më e rëndësishmja që ky është vitit i parë në të cilin pasqyrat financiare të BKK-së janë përgatitur pa involvimin e mbështetjes së kontabilitetit të jashtëm. Më tepër, brenda në MEF është themeluar njësi i dedikuar për përgatitjen e barazimit të gjitha llogarive bankare të BKK-së. Sipas mendimit tonë janë zhvillime shumë pozitive.

Më pak pozitive, revizioni i draftit të pasqyrave financiare pasoi me një numër të madh të amendamenteve për ato pasqyra. Edhe pse kjo është e pranueshme në kohën e tranzicionit, mbetemi me shpresë dhe presim që nevoja për amendamente të tilla në vitet e ardhshme do të ulet.

Më e rëndësishmja , megjithatë:

- Si në vitet e kaluara, pasqyrat e Rrjedhjes së Parasë përbëjnë një diferencë të pabarazuar
- Për disa llogari bankare të BKK-së nuk ka barazime

Përgjithësisht ne konkludojm që dobësi të rëndësishme mbesin në përforcimin e procesit të përgatitjes dhe prodhimit të pasqyrave financiare, dhe se këto dobësi dëmtojnë kredibilitetin e pasqyrave pasqyrave.

## **4 Komentet e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm**

36

Në shkurt të vitit 2006, PSSP na e dërgoi përgjigjen e tij mbi draft-raportin tonë të auditimit për vitin 2004.

PSSP i kupton vërejtjet dhe rekomandimet në raport të Auditimit si shumë të dobishme. Ato tregojnë që është arritur shumë progres gjatë disa viteve të kaluara. Në të njëjtën kohë, ka sigurisht fusha të caktuara të shqetësimit që duhet të adresohen. Sapo të lëshohet raporti i auditimit në publik, PSSP synon ta inkurajojë Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave tu kërkojë autoriteteve përkatëse publike financiare të zhvillojnë një plan veprimi për implementimin e rekomandimeve të auditimit dhe raportojnë mbi progresin e tyre.

### **Komentet përfundimtare të Zyrës së Auditorit Gjeneral të Kosovës**

ZAGJ mirëpret synimet e PSSP për të inkurajuar MEF që tu kërkojë autoriteteve përkatëse publike financiare të zhvillojnë plane veprimi për implementimin e rekomandimeve të auditimit dhe raportojnë mbi progresin e tyre.

Siç është përcaktuar nga Rregullorja Nr. 2005/33 e cila e amendamenton Rregulloren 2002/18 mbi Themelimin e ZAGJ në Kosovë dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës, pas publikimit të raportit të auditimit ZAGJ pret që Organizatat Buxhetore, brenda 30 ditësh, do të dorëzojnë një raport Auditorit Gjeneral që tregon se si ata synojnë të implementojnë rekomandimet e dhëna në raportin e auditimit.

# Opinionit i Revizionit për pasqyrat financier të BKK-së për vitin 2004

## Hyrje

Ne kemi bërë revizionin e pasqyrave financiare të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për vitin 2004 (siç është përfshirë në këtë raport). Këto pasqyra financiare janë përgjegjësi e Misionit të Kombeve të Bashkuara për Administrim të Përkohshëm në Kosovë. Përgjegjësia jonë është që në bazë të revizionit tonë të shprehim mendimin mbi këto pasqyra financiare.

## Fushëveprimi

Ne kemi kryer revizionin tonë në pajtim me standardet e pranuar të revizionit në përgjithësi. Këto standarde kërkojnë që të planifikojmë dhe kryejmë revizionin për të arritur siguri të arsyeshme për atë se nëse pasqyrat financiare nuk kanë material të gabuar bilanciar. Revizioni përfshinë verifikimin e testit, dëshmime që mbështesin vlerat dhe informatat në pasqyrat financiare. Revizioni gjithashtu përfshinë vlerësimin e parimeve të përdorura të kontabilitetit dhe vlerësimet e rëndësishme të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të përgjithshëm të pasqyrave financiare. Ne besojmë se revizioni ynë siguron bazë të arsyeshme për opinionin tonë.

## Çështjet që prekin opinionin

Duke pasur parasysh kushtet e pas luftës në Kosovë dhe procesi i ndërlikuar i krijimit të institucioneve themelore, sistemeve dhe regjistrimeve, UNMIK-u nuk ka mundur të krijojë dhe mbajë kontrolle të duhura me burimet në disponim. Si pasojë ne nuk kemi mundur të kryejmë procedura të mjaftueshme revizioni për të fituar siguri të arsyeshme mbi pasqyrat financiare si tërësi.

**Opinion**

**38**

Për arsye të përshkruar në paragrafin paraprirës , nuk mund të shprehim mendimin për atë se nëse pasqyrat financiare marrë si tërësi japin një pasqyrë të vërtetë dhe të drejtë .

Zyra e Revizionit Gjeneral,  
Prishtinë, Kosovë  
XX Dhjetor 2005

## Aneksi 1 Lista e shkurtesave

LVR	Lista e Veprimeve të Revizionit
RGJ	Revizori Gjeneral
AQF	Autoriteti Qendror Fiskal
NJQP	Njësia Qendrore e Prokurimit
UZP	Urdhër Obligimi Pagese
QPS	Qendra për Punë Sociale
ABDH	Administratorë i Bazës së të Dhënave
UAF	Urdhëresa Administrative Financiare
NJRB	Njësia e Revizionit të Brendshëm
FNK	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
FMN	Fondi Ndërkombëtar Monetar
TI	Teknologjia Informativë
BKK	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
KEK	Korporata Elektroenergjetike e Kosovës
SHPK	Shërbimi Policor i Kosovës
AKM	Agjencia Kosovare e Mirëbesimit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MPS	Ministria e Shërbimeve Publike
GJHR	Gjykata Holandeze e Revizionit
ZRGJ	Zyra e Revizionit Gjeneral
NJMO	Njësia e Menaxhimit Operativ
IPVQ	Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse
ORPP	Organi Rregullativ i Prokurimit Publik
PTK	Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës
HK	Hekurudhat e Kosovë
AR	Agjencitë e rezervuara
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
KB	Kombet e Bashkuara
UNMIK	Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

